

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurve, A. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] dhe R. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] i fsh. M. [REDAKTUE] K. Prizren, të akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 13 e dt. 30.03.2016, për shkak të veprës penale kanosje nga nen 185 lëndim i lehtë trupor nga nen 188, vjedhje nga nen 325 dhe sulm nga nen 187 i KP-së në prezencën e të akuzuarve prokurorit te shtetit Musli Gashi, më dt.02.06.2017, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

A. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] i lindur me 03.12.1979 ne fsh. M. [REDAKTUE] ku edhe jeton, nga i ati J. [REDAKTUE] eëma R. [REDAKTUE] i lindur M. [REDAKTUE], ka te kryer shkollën e mesme, i martuar baba i 4 fëmijëve, punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar shtetas i R. te Kosovës.

M. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] e lind. me 02.02.1976 ne fsh. M. [REDAKTUE] ku edhe jeton, nga i ati J. [REDAKTUE] eëma R. [REDAKTUE] i lind. M. [REDAKTUE] ka te kryer shkollën e mesme, e martuar nene e 3 fëmijëve, punëtore, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar shtetas i R. te Kosovës.

E. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] i lind. me 16.11.1957 ne Z. [REDAKTUE] tani me banim ne fsh. M. [REDAKTUE], nga i ati A. [REDAKTUE] dhe e ema R. [REDAKTUE] ka te kryer shkollën filllore, e martuar ne nën e 3 fëmijëve, amvise e gjendjes se dobët ekonomike, boshnjake - shtetase i R te Kosovës

JANË FAJTOR

Sepse:

- I. A. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] me dt. 22.03.2014 rrëth orës 14:15 në fsh. M. [REDAKTUE] K. Prizren, në oborrin e shtëpisë familjare, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin M. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] motrës së tij në atë mënyrë që deri sa M. [REDAKTUE] ishte duke e goditur bashkëshorten e A. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] I. [REDAKTUE] Th. [REDAKTUE] i njëjtë ndërhyr për ti ndarë dhe i shkakton lëndime të lehta trupore lëndime këto të konstatuara në mendimin e ekspertit mjek ligjor Dr. E. [REDAKTUE] B. [REDAKTUE] dhen me 22.05.2014. Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nen 188 parag 1 të KP-së.
- II. Me dt. 25.06.2014 në orë të pa çaktuar, në fsh. M. [REDAKTUE] K. Prizren, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër merr pasurinë e luajtshme të të dëmtuarit R. [REDAKTUE] A. [REDAKTUE] rrëthoja e oborrit të shtëpisë në atë mënyrë që shfrytëzon rastin e volitshëm mos prezencën e të dëmtuarit i cili ishte në Gjermani dh nga oborri i tij merr rrëthoja e shtëpisë me gjatësi 42 m, i dërgon në hekurishten " [REDAKTUE]" në fshatin [REDAKTUE] dhe i shet. Këso dore ka kryer veprën penale të vjedhjes nga nen 325 parag 1 të KP-së

III. Mirsada dhe Fazile Ahmetaj me dt 22.03.2014 rreth orës 14:15 në fsh Malësi e Re, K Prizren, në oborrin e shtëpisë familjare, në bashkëveprim me dashje përdorin forcën ndaj të dëmtuarës L. Th. – nuses së tyre në atë mënyrë që kur e dëmtuara del në oborr me fëmiun e saj e pandehura M. i drejtohet me fjalët: “Kadal kurva me djalin invalid”, atëherë e dëmtuara ndihet e ofenduar dhe i drejtohet me fjalët : “Mshele”, dhe në atë moment e pandehura M. e godet me shqelm në bark dhe e kap për flokësh ndërsa e pandehura R. e godet me një papuhe por nuk i shkaktojnë lëndime të dukshme trupore.

Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale sulm nga neni 187 parag 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

IV. Mirsada dhe Fazile Ahmetaj me dt. 13.05.2014, në intervalin kohor prej 15:00 deri – 17:00 në fsh. _____ në shtëpinë familjare, në bashkëveprim me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër marrin pasurinë e të dëmtuarës L. Th. – arin, në atë mënyrë që shfrytëzojnë momentin e volitshëm mos prezencën e të dëmtuarës, e hapin derën me çelës hyn në dhomë, hapin sefin e mbyllur me kod dhe nga aty marrin stoli ari si : kompletin e qafës, vath dhe unazë, tri unaza tjera me gurë dhe një zingjir të trashë. Kur e dëmtuara kthehet në shtëpi vëren se të gjitha stolit e arit të cilat i kishte të mbyllura në sef me kod, i mungonin, ndërsa stolit e argjendit dhe bizhuteritë i kishte në çantë.

Këso dore në bashkë kryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 parag 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 80 të KP-së, të akuzuarve u shqipton:

DËNIM ME KUSHT

A. A., për veprën penale nën I të këtij dispozitivi, me burg në kohë zgjatje prej 4 muaj.

Për veprën penale nën II të këtij dispozitivi me gjobë në shumë prej 400 euro dhe me burg në kohëzgjatje prej gjashtë muaj.

Dënimet nuk do të ekzekutohet, në afatin prej 1 viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i pandehuri nuk kryen vepër të re penale.

M. A., për veprën penale nën III. të këtij dispozitivi me burg në kohë zgjatje prej 4 muaj.

Për veprën penale nën IV të këtij dispozitivi dënohet me gjobë në shumë prej 500 euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej një viti.

Dënimet nuk do të ekzekutohet, në afatin prej 2 vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse e pandehura nuk kryen vepër të re penale.

F. A., për veprën penale nën III. të këtij dispozitivi me burg në kohë zgjatje prej 4 muaj.

Për veprën penale nën IV të këtij dispozitivi dënohet me gjobë në shumë prej 500 euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej një viti.

Dënimet nuk do të ekzekutohet, në afatin prej 2 vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse e pandehura nuk kryen vepër të re penale.

Bazuar në nenin 80 të KP-së të akuzuarve u shqiptohet :

D E N I M I U N I K

A [REDACTED] A [REDACTED]

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 9 muaj, dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 euro të cilat dënlime nuk do të ekzekutohen në afatin verifikues prej 1 viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuar nuk kryen veprer të re penale.

M [REDACTED] A [REDACTED]

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 14 muajve, dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 euro të cilat dënlime nuk do të ekzekutohen në afatin verifikues prej 2 viteve nga e dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse e akuzara nuk kryen veprer të re penale.

F [REDACTED] A [REDACTED]

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 14 muajve, dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 euro të cilat dënlime nuk do të ekzekutohen në afatin verifikues prej 2 viteve nga e dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse e akuzara nuk kryen veprer të re penale.

Obligohen te pandehurit qe në mënyre solidare ti paguajnë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato behën ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër të tē paushallit gjyqësor secili veq e veq të paguajnë shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore ne Prizren, ka paraqitur aktakuzën PP.nr. V13 e dt. 30.03.2016, kundër te fakuzuarve J [REDACTED] A [REDACTED], A [REDACTED] A [REDACTED], M [REDACTED] A [REDACTED] dhe F [REDACTED] A [REDACTED] për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 i KP-së, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 i KP-së, vjedhje nga neni 325 i KP-së, sulmit nga neni 187 i KP-së dhe veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 i KP-së.

Me aktvendimin P.nr.669/16 të datës 26.04.2017 gjyqtari gjykues pushon procedurën penale ndaj të akuzuarit J [REDACTED] A [REDACTED] për shkak se i njëjti tani më është i ndjerë.

Gjyqtari gjykues konstaton se vepra penale nën I të aktakuzës, kanosje nga neni 185 i KP-së, është kryer me 22.12.2012 ku dënnimi për këtë veprer është paraparë me gjobë apo me burgim deri në 6 muaj, andaj bazuar në ninen 106 parag 1 pika 1.6, dhe neni 107 parag 8 të KP-së kemi të bëjmë me parashkrim absolut ngase ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Në shqyrtimin fillestar të dt, 26.04.2017, i akuzuarit A [REDACTED] A [REDACTED] me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë i njëjti në tërësi e ka pranuar fajin. Gjykata me aktvendim aprovon pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit A [REDACTED] A [REDACTED].

Në shqyrtimin gjyqësor të dt. 02.06.2017 të akuzuarat M [REDACTED] dhe F [REDACTED] A [REDACTED] gjithashtu me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë të njëjtat në tërësi e kanë pranuar fajin. Gjykata pas marrjes së mendimit edhe të prokurorit të shtetit konstaton se janë përbushur kërkosat nga neni 248 i KPP-së, andaj pranimin e fajësisë e aprovon.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaron: Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë në këtë çështje penale u dëshmua dhe u vërtetua se gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë. Andaj kërkoj nga gjykata që të akuzuarve t iu shqiptohet dënnimi sipas ligjit, kurse për bazë me rastin e caktimit të llojiit dhe lartësisë së dënnimit të merret fakti se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë si dhe

E dëmtuara L. [REDACTED] deklaron se tani me këtu të akuzuarën M. [REDACTED] dhe R. [REDACTED] A. [REDACTED] i kanë përmirësuar raportet, dhe se nuk paraqet kërkesë pronësore juridike.

E akuzuara M. [REDACTED] A. [REDACTED] në fjalën përfundimtare deklaron se i vjen keq për atë që ka ndodhur, premtan gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale, kjo është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin kurse tani raportet me këtu të dëmtuarën i kanë rregulluar. E akuzuara R. [REDACTED] A. [REDACTED] në tërësi e mbështet fjalën e të akuzuarës M. [REDACTED] A. [REDACTED]

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit A. [REDACTED] A. [REDACTED] përbushen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga nen 188 para 1 të KP-së, veprës penale të vjedhjes nga nen 325 parag 1 të KP-së kurse në veprimet e të akuzuarave M. [REDACTED] dhe R. [REDACTED] A. [REDACTED] përbushen elementet e veprës penale sulmi nga nen 187 parag 1 lidhur me nenin 31 të KP-së si dhe veprës penale vjedhje e rëndë nga nen 327 parag 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Gjatë matjes dhe caktimit të dënimit gjykata aplikoi nenin 73 dhe 74 të KP-së për të gjetur dhe çmuar faktin se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë andaj janë përbushur kushtet ligjor që ndaj të akuzuarve të aplikohen dispozitat mbi zbutjen e dënimit duke shqiptuar dënim me burgim nën minimumin ligjor gjegjësisht në zbatim të nenit 51 dhe 52 të KP-së shqiptoi dënimin me kusht dhe atë me aplikimin e nenint 75 dhe 76 të KP-së me bindjen se edhe me kto dënim do të arrihet qëllimi i tyre.

Më rastin e shqiptimit të dënameve kjo gjykate pati parasysh rrethanat lehtësuese per të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur, premtimin se në të ardhmen nuk do te bien ndesh me ligjin, sjelljen korrekte para gjykatës, janë familjar, dhe se për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe pashallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 te KPK-se.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të ketij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.669/16 të dt.02.06.2017

Procesmbjatesja:
Halime Nixha



DHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankes, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit ne Prishtine , e nëpërmjet të kesaj gjykate.